



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI**

*Nr.1447/ 11 prot.*

*Tiranë, më 30.09.2019*

**V E N D I M**

**Nr.105, Datë 30.09.2019**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS ELBASAN, “MBI  
AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE”**

**për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2018.**

Nga auditimi i ushtruar në Degën e Doganës Elbasan, rezultoi që, ka mospërputhje në procedura; të meta e mangësi në zbatimin e legjislacionit dhe akteve administrative që rregullojnë funksionimin e institucionit në drejtim të procesit të vlerësimit e pranimit të deklaratave doganore të subjekteve të biznesit dhe individëve, objekt i veprimtarisë së doganave, të cilat kanë sjellë për pasojë mungesë të ardhurash për Buxhetin e Shtetit.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Kontrollit të Cilësisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**VENDOSA**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit, “Për vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator, mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Dega e Doganës Elbasan, sipas programit të auditimit nr. 1447/1 prot., datë 14.01.2019, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2018”.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

## A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi i dokumentacionit për procedurat e doganore të subjekteve që operojnë sipas ligjit nr. 61 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSH” nga të dhënat e marra nga sistemi Assycuda Word mbi deklaratimet vjetore të akcizës dhe të dhënave të nxjerra nga Dega Doganore Elbasan u konstatuan diferenca në tepricë dhe në mangësi midis të dhënave të paraqitura si dhe prodhim të mallrave të shitura nga magazina fiskale prodhimi të produkteve energjetike, për të cilat u evidentuan dhe u llogaritën detyrime të taksës kombëtare të karbonit, në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, në shumën **32,389,437 lekë** për **dy subjekte** për të cilat në dosjet respektive të subjekteve nuk disponohej dhe nuk konfirmohej pagesa në nivelin 3 lekë/kg pranë Drejtorive Rajonale Tatimore respektive.

(Më hollësisht trajtuar pikën 4, faqe nr. 77-146 dhe aneksi nr. 4.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**Rekomandimi 1.1.** Dega Doganore Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të veprjës menjëherë për ndjekjen dhe marrjen e konfirmimit pranë Drejtorive Rajonale Tatimore respektive për shumën e detyrimeve të taksës kombëtare të karbonit të llogaritur nga sasitë vjetore të prodhuara në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, në shumën **32,389,437 lekë** për dy subjekte me qëllim konfirmimin e pagesave të kryera për vitin 2017 dhe 2018 nga këta dy operatorë si dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 61/2012 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” të kryejë verifikime dhe kontrole specifike pranë regjistrave të kontabilitetit të operatorëve ekonomikë dhe ambienteve të deklaruara në autorizimet e marra me status depozitues të miratuar për dy operatorë për diferencat në tepricë dhe në mangësi.

*Në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi u konstatua se gjatë veprimtarisë të ushtruar në fushën e regjimeve doganore ekonomike për kryerje të aktivitetit tregëtar në fushën e regjimeve doganore ekonomike, janë kryer procedura doganore të tipit P/4051<sup>1</sup>, hedhje në qarkullim të lirë sasinë prej 1206 kg “*film plastik*” me vlerë malli 36,180 lekë në ndryshim nga vlera fillestare mesatare e importuar për këtë artikull në kreun tarifor \*391910\* me një çmim mesatar hyrës prej 260 lekë/kg duke mbartur një vlerë totale prej 313560 lekë për sasinë **prej 1206 kg produkt të gatshëm, e cila nuk është film polietileni në gjendje të re por në gjendje mbeturinë**. Gjithashtu konstatohet se pas rakordimeve të kryera nga grupi auditues sipas të dhënave të marra nga sistemi Assycuda Word, rezulton se dy praktika doganore me sasi totale prej 20393 kg të kryera me procedurën 5151<sup>2</sup>, janë jashtë afatit autorizues të përcaktuar në autorizim, për **në shumën 453,617 lekë** për **dy operatorë** ekonomik.

Gjithashtu rezultojnë për 2 operatorë, procedura të mbylljes së regjimeve doganore ekonomike me tejkalim të sasive në njësinë matëse kg por të përputhur në njësinë autorizuese m<sup>3</sup> në procedura eksporti si dhe transferime të sasive të mallrave nga regjime

<sup>1</sup> 4051- Lejimi për përdorim të brendshëm të mallrave më parë të vendosura në sistemin me pezullim të përpunimit aktiv.

<sup>2</sup> 5151 -Transferimi i mallrave nën Regjimin e Përpunimit Aktiv nga një autorizim tek tjetri.

ekonomike të tipit RPA për të cilat nuk janë kryer kontrole pranë subjekteve autorizues bazuar në profile risku të ndërtuara nga Dega Doganore Elbasan **në shumën 8,429,121 lekë** (Më hollësisht trajtuar pikën 4, faqe faqet nr. 77-146 dhe aneksi nr. 4.2 dhe nr. 4.3 të Raportit të Auditimit)

**Rekomandimi 2.1.** Dega Doganore Elbasan nëpërmjet personelit përpunues doganor dhe dokumentar të zyrës së regjime/akcizë/përrjashtime në bazë të nenit 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndërtojë programe kontrolli të detajuar për të verifikuar për faktet dhe provat e paraqitura në materialin e Raportit të Auditimit për autorizimet që janë evidentuar në këtë material me veprimtari për vitin 2017 dhe për vitin 2018 trajtuar sa më sipër me qëllim “verifikimin e saktësisë dhe plotshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratat doganore që janë deklaruar duke përfshirë marrjen e mostrave dhe kontrollin fizik dhe kontabël pranë selive të operatorëve deklarues” si dhe në vijim në rast të konstatimit të detyrimeve doganore të marrë në konsideratë edhe nenin 23 “Dhënia e informacionit autoriteteve doganore” dhe 256 “Shkeljet Doganore” të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë për 4 operatorë përfitues të regjimeve doganore ekonomike të tipit RPA në shumën totale 8,882,738 lekë.

### Menjëherë

**3. Gjetje nga auditimi:** Gjendja borxhit doganor/ akcizës rezulton në fund të vitit 2016 në shumën 258,395,037 lekë, në fund të vitit 2017 në shumën 212,402,445 lekë dhe në fund të vitit 2018 në shumën 232,584,641 lekë. Borxhi doganor në vitin 2017/2016 ka një ulje në shumën 102,669,176 lekë ose 32.5% nga e cila ndikimi i ligji i faljes nr. 33/2017 për subjekte të shpallur debitore mbi detyrime doganore, gjoha e kamatëvonesa të pa paguara është në shumën 60,721,724 lekë ose 19% e pakësimit të borxhit. Borxhi doganor në vitin 2018/2017 ka pësuar rritje në shumën 20,182,196 lekë ose 8% më shumë se viti paraardhës duke mos kryer në kohë veprimet ligjore sipas kërkesave të ligjit dhe udhëzimeve përkatëse, me ndikim në rritjen e riskut në rikuperimin e borxhit dhe po ashtu dhe në rritjen e tij. Kjo mënyrë e rikuperimit të borxhit doganor/akcizës nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit Ligji nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”

(Më hollësisht trajtuar pikën 5, faqe nr. 146-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**3.1 Rekomandime:** Dega Doganore Elbasan, në bashkëpunim me DPD dhe institucione të tjera të përmendura në Udhëzimi nr. 4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, të marrin masa konkrete dhe efektive për të zgjidhur sa më shpejt dhe në rrugë ligjore rikuperimin e borxhit doganor **në shumën 232,584,641 lekë**, nëpërmjet krijimit të akt marrëveshjeve të reja me subjektet doganore si dhe rritjes së bashkëpunimit me institucionet e tjera, për të bërë të mundur rikuperimin e tij.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se Dega Doganore Elbasan në vitin 2017 ka arkëtuar të ardhura doganore në shumën 2,895,351 mijë lekë, me realizim në masën 113 % kundrejt planit vjetor 2,555,483 mijë lekë ose më shumë në vlerën 1,098,627 mijë dhe në vitin 2018 ka arkëtuar të ardhura në shumën 2,651,418 mijë lekë, me realizim në masën 86

% kundrejt planit 3,079,423 mijë lekë, ose më pak në vlerë 428,006 mijë lekë. Ecuria e realizimit të treguesve të të ardhurave doganore është përkeqësuar kryesisht në 6-mujorin e dytë të vitit 2018, ku gati për çdo muaj rezulton me mosrealizim të të ardhurave doganore. Konstatohet se për ndryshimet e planit mujor nuk u paraqit për çdo rast dokumentacion që reflekton ndryshimin e planit, kjo kryesisht në muajin maj, qershor 2017 si dhe shtator 2018. Planifikimi të ardhurave nga DPD dhe raportimet në DPD nga AD kanë mospërputhje në procesin e planifikimit, situatë e cila vihet re në çdo muaj kalendarik si dhe në total. Kështu nga DPD për vitin 2017 në total rezultojnë më pak të ardhura të planifikuara 31,190 mijë lekë dhe në vitin 2018 më shumë të ardhura të planifikuara në shumën 158,261 mijë lekë. Kjo mënyrë e planifikimit por dhe e detajimit mujor të planit të të ardhurave nga ana e DPD tregon për një planifikim jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 4, neni 24, ligjit nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, kap. IV. “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave”.

(Më hollësisht trajtuar pikën 2, faqet nr. 27-34 dhe aneksin nr. 2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**4.1. Rekomandimi:** Dega Doganore Elbasan në të ardhmen të rrisë bashkëpunimin me Sektorin e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave në DPD për përmbushjen e misionit që i është ngarkuar sipas ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH” i ndryshuar dhe ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, në përputhje me funksionet që ata kryejnë në të gjitha fazat e programimit të të ardhurave, me qëllim shkëmbimin e të dhënave për subjektet kontribuese që mundësojnë krijimin e të ardhurave për të bërë të mundur që treguesit e të ardhurave doganore të programohen objektivisht .

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi u konstatua se nga personeli përpunues doganor nuk janë marrë në konsideratë përcaktimet ligjore të shpjegimeve të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë” dalë sipas ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 për “Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim–Asocimit” neni 22 “Kushtet për bërjen e një deklarate faturë” pika 2, 3 4, 5 dhe 6, duke mos dërguar për verifikim doganor Deklaratat Faturë dhe Dokumentet Eur. 1 për “mallrat e përdorur” sipas praktikave të evidentuara në këtë Raport Auditimi, për një subjekt me shumë të detyrimit doganor në vlerën 425,734 lekë për tre deklarata doganore.

(Më hollësisht trajtuar pikën 3, faqet nr. nr. 34-77 dhe aneksin nr. 3.18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**Rekomandim 5.1.** Dega Doganore Elbasan të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për analizimin e praktikave doganore të cituara me qëllim verifikimin e dokumentacionit tregëtar EUR. 1 dhe Deklaratë Faturë të përdorur për përfitimin e kushtit të origjinës preferenciale MSABE dhe MTLTR pranë Autoriteteve Doganore Homologe sipas rasteve të përmendura në këtë Raport Auditimi për 3(tre) raste pranë Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe bazuar në përcaktimet e nenit 204 deri 214 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara”

dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, të kërkojë dhe garantim të borxhit doganor që mund të lindë për deklarime doganore të evidentuara sa më sipër deri në përfundim të verifikimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë Autoriteteve Doganore Homologe.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Dega Doganore Elbasan nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse përcjellë me shkresën përcjellëse nga KLSH me shkresën dërguar me shkresën nr. 1229/11 prot, datë 30.04.2017 dhe shkresën nr. 1602/6, datë 05.02.2018.

*(Më hollësisht trajtuar pikën 1, faqet nr. 15-27 dhe aneksin nr. 1 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**6.1.Rekomandimi:** Dega Doganore Elbasan, në cilësinë e organit administrativ të juridiksionit të analizojë rekomandimet e pazbatuara, si dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese, administrative dhe gjyqësore për **1 masë** organizative si dhe për verifikimin, vendimmarrjen dhe kontabilizimin e shumës së dëmit ekonomik prej **6,001 mijë lekë** rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë me shkresën nr. 1229/11 prot, datë 30.04.2017 dhe shkresën nr. 1602/6, datë 05.02.2018.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **B. 1 MASA SHPERBLIM DEMI**

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin e Auditimit, nga Dega e Doganore Elbasan të analizohen rekomandimet e trajtuara në këtë material dhe të kryhet kontabilizimi dhe të kërkojë në rrugë të menjëhershme ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për arkëtimin e të ardhurave doganore të munguara **në Buxhetin e Shtetit në shumën 39,973,216 lekë** në mënyrë analitike si më poshtë:

### **1. Gjetje nga auditimi.**

Nga auditimi u konstatua se nga personeli përpunues doganor nuk janë rillogaritur me saktësi elementët e vlerës doganore për efekt taksimi doganor, për raste të mospagimit të taksës kombëtare të ambalazhit plastik, për mos llogaritje të shpenzimeve të transportit për qëllime të vlerësimit doganor duke krijuar të ardhura doganore të munguara të rillogaritura në **shumën 34,912,345 lekë**, veprime jo nw përputhje me *shpjegimet e Nomenklaturës së Mallrave në RSH dhe në mos përmbushje të nenit 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”* i ndryshuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i shfuqizuar, Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të DPD, “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, Udhëzimit nr. 3 të MF datë 25.01.2018 “Për Vlerësimin Doganor” shkresës nr. 779 prot DPD datë 16.01.2013 “Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”,

*(Më hollësisht trajtuar pikën 3, faqe nr. 34-77 dhe aneksi nr. 3.1 deri nr. 3.7; dhe nr. 3.19 deri nr. 3.20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Rekomandimi 1.1.** Dega Doganore Elbasan të ndjekë të gjitha rrugët ligjore me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative për kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore në **shumën 34,912,345 lekë** për periudhën nën juridiksion auditimi nga data 01.01.2016 deri në datën 31.12.2017 që lidhen me rilogaritje pagesash detyrime doganore në import për të cilat nuk është vepruar në përputhje dhe mbështetje të shpjegimeve të nenit 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të DPD ,”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”,Udhëzimit nr. 3 të MF datë 25.01.2018 “Për Vlerësimin Doganor”, shkresës nr. 779 prot DPD datë 16.01.2013 “*Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE*”.

***Deri më 30.11.2019***

**2. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi i procedurave doganore gjatë mbikëqyrjes së regjimeve doganore ekonomike rezultuan veprime që kanë sjelle pasoja në mosrespektim të afateve dhe sasive autorizuese që lidhen me veprimtarinë e operatorëve ekonomike që janë autorizuar të operojnë në fushën e regjimeve doganore ekonomike të përpunimit aktiv dhe pasiv si dhe regjimeve doganore ekonomike të lejimit të përkohshëm sipas përcaktimeve nenit 83, 160, 256, 273, 271 të ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH” i ndryshuar, ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”, VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, për periudhën e juridiksionit të auditimit në **shumën totale 1,487,732 lekë** e konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RPA dhe RLP

*(Më hollësisht trajtuar pikën 4, faqe nr. 77-146 dhe aneksi nr. 4.1 dhe nr. 4.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2.1 Rekomandimi.** Dega Doganore Elbasan të ndjekë dhënien e destinacionit të mallrave të hyra sipas autorizimeve të tipit RLP dhe RPA konform shpjegimeve të nenit 83 dhe 160 të Kodit Doganor në RSH, me qëllim dhënien e destinacionit përfundimtar doganor për mallrat e hyra në territorin doganor shqiptar me deklarime doganore IMP5 sipas procedurave të zgjeruara doganore 5100 dhe 5500 të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Bazuar në të dhënat e deklaratave doganore të pranuar për të cilat është vërtetuar mos eksportimi i sasive të autorizuara për regjimet RPA dhe të deklarimit të destinacionit doganor IMP 4 “hedhje në qarkullim të lirë” për regjimet RLP arkëtimi i detyrimeve doganore dhe gjobave doganore në shumën totale prej **shumën totale 1,487,732 lekë** të konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RPA, për shkelje doganore të kryera nga operatorë tregtarë, në kundërshtim dhe tejkalim të afateve administrative autorizuese, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, me qëllim arkëtimin e detyrimeve dhe sanksioneve doganore.

***Deri më 30.11.2019***

**3. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të nxjerra për shkeljet në fushën doganore për periudhën nën auditim rezultuan vendimeve administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, i shfuqizuar, nenit 3, pika 2 dhe 6, të Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare i Ndryshuar”, Ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe përcaktimeve të VKM nr. 205

datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, në shumën totale **764,286 lekë** për **5 raste** vendimesh administrative të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2017 dhe 2018.

(Më hollësisht trajtuar pikën 6, faqet nr. 163-172 dhe aneksi nr. 6.1 dhe aneksi nr .6.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

**Rekomandimi 3.1.** Dega Doganore Elbasan të kërkojë ndryshimin ose revokimin në rrugë ligjore për rishikime vendimesh administrative në shumën totale **764,286 lekë** për **5 raste** vendimesh administrative të vitit 2017 dhe 2018 duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim nxjerrjen dhe arkëtimin e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore bazuar në ligjin nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar dhe ligjin nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë

*Deri më 30.11.2019*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për procedurat e doganore të subjekteve që operojnë sipas ligjit nr. 61 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSH” gjatë rakordimit të bilancit material të disa operatorëve me status depozitues të miratuar, u konstatuan diferenca për mallra të hyra në prodhim dhe sasive të nxjerra si produkt përfundimtar, në shumën totale **1,808,354 lekë** për 8 raste/subjekte, veprime këto të kryera jo në përputhje me gërmën (c) të pikës 3, neni 20 dhe 85 të ligjit nr. 61, datë 24.05.2012 për “Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me Manualin Praktik nr. 13047 dhe nr. 13048 prot DPD datë 20.05.2016,

(Më hollësisht trajtuar pikën 4, faqet nr. 77-146 dhe aneksi nr. 4.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**4.1.Rekomandimi:** Dega Doganore Elbasan nëpërmjet Sektorit të Akcizës të kërkojë arkëtimin e detyrimit doganor dhe sanksioneve doganore, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke kryer verifikime dhe kontrole specifike pranë regjistrave të kontabilitetit të operatorëve ekonomikë dhe ambienteve të deklaruara në autorizimet e marra me status depozitues të miratuar, trajtuar në Raportin e Auditimit, me qëllim arkëtimin e detyrimit doganor konstatuar në shumën totale në shumën totale **1,808,354 lekë** për **8 raste/subjekte**.

*Deri më 30.11.2019*

**5. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore, u konstatua se nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është vepruar jo në përputhje me kërkesat e nenit 8, pika 1, shkronja “g”, neni 9 “Tarifat tatimore”, pika 2, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar”, si dhe pikës 2.4.8 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, ndryshuar me Udhëzimin Nr. 23, datë 30.7.2013. (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 134, date 9.08.2013), për tatimin mbi të ardhurat personale **për 1 rast**, të rikthyer në punë me vendim gjykate të formës së prerë.

(Më hollësisht trajtuar pikën 7, faqet nr. 172-187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

**5.1 Rekomandimi:** Dega e Doganës Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e tatimit mbi të ardhurat personale në shumën **499,071 lekë**

Në vijimësi

## **B.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E ARDHURAVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, nga personeli përpunues doganor nuk janë rillogaritur me saktësi elementët e vlerës doganore për efekt taksimi doganor, që lidhen me vlerësimin doganor artikujve që janë deklaruar në kapitullin \*02<sup>3</sup>\*, pasi janë evidentuar diferenca të rillogaritura me çmimet e publikuara sipas Dosjes së të Dhënave të Disponueshme në RS, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e Sesionit I-rë të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme”, të neneve 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nëpërmjet zbatimit të shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr. 1945 prot, datë 25.01.2016 “Mbi zhdoganimin e artikujve që deklarohen në kapitullin \*02\* me origjinë nga EU”, dhe shkresës nr. 2344 prot., datë 28.01.2016, **duke shkaktuar efekt financiar negativ në vlerën 29,450, 411 lekë.**

Gjithashtu gjatë auditimit ka rezultuar se, nga të dhënat e marra nga “data base” i deklarimeve doganore, për deklarimet periodike doganore sipas çdo 3-mujori respektiv të vitit 2017, krahasuar këto me deklarimet e çdo 3-mujori periodik pasues gjatë këtij viti, rezulton një vijueshmëri niveli të transaksioneve të deklaruara për gjatë gjithë vitit dhe se transaksionet e kryera janë përafërsisht në të njëjtin nivel me deklarimet dhe transaksionet e kryera për vitin 2016. Nga procesi auditues u administruan verifikime doganore të dërguara për vitin 2016, 2017, 2018 dhe 2019 për dy subjekte si dhe përgjigje verifikimi ardhura nga Autoritetet Doganore Homologe si, Greqia, Polonia, Holanda, Danimarka, Britania, Gjermania, Spanja me të cilët Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka Marrëveshje Reciproke Bashkëpunimi, të cilat rezultojnë të rregullta.

Gjithashtu, në lidhje me këtë problematikë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit i është kthyer edhe një përgjigje Shoqatës “Albanian Food Industry” me shkresën nr. 43/2 prot., datë 27.02.2018, me lëndë “Kthim Përgjigje mbi pretendimet e ngritura nga Shoqata “Albanian Food Industry” në dy letrat nr. 84 dhe nr. 85, datë 08.01.2018”, duke e adresuar njëkohësisht këtë përgjigje për Kryeministrin e RSH, Ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave, ridrejtuar përsëri Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 232 datë 20.12.2018

(Më hollësisht trajtuar pikën 3, faqet nr. 34-77 dhe anekset nr. 3.14; nr. 3.15, nr. 3.16 dhe nr. 3.17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

**1.1. Rekomandimi:** Dega Doganore Elbasan të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative, për kontabilizimin dhe arkëtimin e

<sup>3</sup> Kapitulli “02”- Mishi dhe të brendshmet e ngrënëshme të mishit



detyrimeve doganore për dy subjekte në **shumën 29,450,411 lekë**, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më 31.12.2018, që lidhen me rillogaritje të detyrimeve doganore në import për deklarime të mallrave të kapitullit \*02\* të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Problematika për kontabilizimin dhe vjeljen e borxhit doganor e trajtuar nga rillogaritja e detyrimeve doganore në procedura importi për deklarime të mallrave të kapitullit II, të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, do të rekomandohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit deri në momentin që Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ose Ministri i Financave dhe Ekonomisë, si Autoriteti Publik më i lartë do të shprehen zyrtarisht për vlefshmërinë ligjore apo shfuqizimin e shkresave të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me nr. 1945 prot, datë 25.01.2016 dhe nr. 2344 prot., datë 28.01.2016, të cilat bien ndesh me përcaktimet dhe trajtimet ligjore të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme*”.

**1.2 Rekomandimi:** Nisur nga fakti se, deri në këtë moment, nuk rezulton asnjë iniciativë ligjore nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ose Ministri i Financave dhe Ekonomisë, si **Autoritete Publike dhe të Kompetencës**, në lidhje me shprehjen e vullnetit të vlefshmërisë apo shfuqizimin e shkresave të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me nr. 1945prot., datë 25.01.2016 dhe nr. 2344 prot, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kërkuar dhe do të kërkojë në vijimësi zgjidhjen e vlefshmërisë ligjore ose shfuqizimin e shkresave të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me nr. 1945 prot., datë 25.01.2016 dhe nr. 2344prot., datë 28.01.2016, të cilat bien ndesh me përcaktimet dhe trajtimet ligjore të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme*”. Nëse Ministri i Financave dhe Ekonomisë, si Autoriteti Publik më i lartë, do të shprehet me një qëndrim vlefshmërie në lidhje me shkresat nr. 1945prot., datë 25.01.2016 dhe nr. 2344 prot., datë 28.01.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ose përputhshmërinë e tyre me përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme*”, mbetet në gjykimin dhe kompetencat e tyre ekskluzive, rikërkimi i detyrimeve doganore të rekomanduara nga Institucioni i KLSH-së, bazuar në përcaktimet dhe hapat ligjorë trajtuar sipas legjislacionit doganor në fuqi, në lidhje me detyrimet doganore të rillogaritura në ngarkim të subjekteve tregtare, të cilët importojnë mallra të deklaruar në kapitullin II me përshkrimin “*Mishi dhe të brendshmet e tij*” të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave në Republikën e Shqipërisë.

**1.3 Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti Doganor Elbasan në vijim të procedurave të mëtejshme, të vlerësojë dhe gjykojë për problematikën e cituar në këtë Raport Auditimi, duke ndjekur dhe respektuar metodat dhe radhën e procesit ligjor të vlerësimit doganor dhe përputhshmërinë me përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 25, datë 16.05.2006 të DPD , “*Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore*”, i shfuqizuar me Udhëzimin nr. 3, datë 23.01.2018 “*Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*” dhe përcaktimeve të neneve 34 deri 36 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i shfuqizuar dhe neneve 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti Doganor Elbasan për problematikën e cituar sa më lart të kryejë dhe ezaurojë të drejtën e procedurave doganore verifikuese pranë selive të kompanive lëvruese të mallit për artikuj të deklaruar në kapitullin II të Nomenklaturës së Mallrave në RSH, pranë Autoriteteve Doganore Homologe respektive bazuar në Marrëveshjet Reciproke

të Asistencës Administrative për parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e shkeljeve doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Vendeve ku janë të atashuara selitë levruese të këtij artikulli me të cilët administrata doganore shqiptare ka Marrëveshje Reciproke Bashkëpunimi dhe Asistencë Doganore, për deklarime doganore të periudhës nën juridiksion auditimi nga Administrata Doganore Shqiptare, duke garantuar njëkohësisht edhe borxhin doganor që mund të lindë.

**1.4 Rekomandimi** Dega Doganore Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave bazuar në nenet 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, të kryejë veprime konkrete verifikuese doganore pranë selive të ushtrimit të aktivitetit të kompanive dhe të regjistrave të kontabilitetit financiar të kompanive të trajtuara në këtë Projekt Raport Auditimi bazuar në përcaktimet e nenit 49, pika 1 dhe 2, ku përcaktohet se “*Autoritetet doganore, pas çlirimit të mallrave, mund të verifikojnë saktësinë dhe plotshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratën doganore.....si dhe ekzistencën, vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti, të verifikojnë kontabilitetin e deklaruesit dhe regjistrime të tjera që lidhen me veprimet që janë kryer mbi mallrat si dhe të verifikojnë këto mallra dhe/ose të marrin mostra, nëse ekziston akoma një mundësi e tillë*”, për saktësim të informacionit të dhënë në deklaratat doganore me qëllim ndjekjen e kontabilizimit të diferencave të munguara në shumën **29,450,411 lekë**.

**Në vijimësi**

## **C. MASA DISIPLINORE:**

Mbështetur në nenin 59, pika 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “*Për nëpunësin civil*” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, i rekomandojmë: Kryetarit të Degës Doganore Elbasan dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave që në vlerësim të shkeljeve, sipas pikës 1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës të atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, sipas nenit 58, shkronja “b”, “c” dhe “ç” të ligjit. nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “*Për nëpunësin civil*”, “*mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj*”; “*pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet*”; deri në, “*Largim nga shërbimi civil*”.

Nga auditimi i ushtruar rezultoi se Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1447/4, datë 28.05.2019 ka dërguar në Degën Doganore Elbasan, Projekt Raportin e Auditimit, me gjetjet dhe rekomandimet për rezultatet e përfundimit të punës audituese në këtë degë doganore. Me shkresën nr. 1523 prot, datë 27.06.2019 protokolluar në KLSH me nr. 1447/5 prot, datë 01.07.2019 Dega Doganore Elbasan informon se Projekt Raport Auditimit i mbajtur nga grupi i audituesve të KLSH-së, nuk është depozituar pranë kësaj dege doganore. Me shkresën nr. 1447/7, datë 04.07.2019, ridërgohet Projekt Raporti i Auditimit. Pas njohjes me gjetjet dhe rekomandimet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, Dega Doganore Elbasan me shkresën nr. 1737/3 prot, datë 16.08.2019 protokolluar në KLSH me nr. 1447/8 prot, datë 20.08.2018 ka përcjellë në KLSH observacionet se bashku me kopjen e Projekt Raportit të Auditimit të dërguar prej nesh. Nga shkresat e sipërcituara rezultojnë se shkresa nr. 1447/4 prot, datë 28.05.2019 është marrë në dorëzim nga Posta Shqiptare.

Gjithashtu Dega Doganës Elbasan konfirmon mbërritjen në këtë degë doganore të shkresës nr. 1447/4, datë 28.05.2019.

Nga sa më sipër Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të analizojë korrespondencën shkresore të sipërcituar duke evidentuar personat përgjegjës që kanë shkaktuar problematikën e konstatuar në administrimin jo të rregullt të dokumentacionit të dërguar në adresë të Degës së Doganës. Elbasan, për veprimet e ndodhura në kundërshtim me nenin 2 germa “f” të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2, datë 12.11.2012.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.*

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**